Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Rrahim Ademi	**24.05.2023**	**29.05.2023**	**2023/0292**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **16.05.2023**, **OE "S.V.„Veterina"**- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: **2023/0292**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE **"DOCTOR EXTERMINATOR DDD SHPK"** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Sherbime te Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit ne objektet Policore**." me nr. të prokurimit: "**214-22-5200-2-1-1**", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **POLICIA E KOSOVËS**.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: **shërbim,** vlera e parashikuar e kontratës: **379,614.27** €..Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Sipas OE ankues AK-ja ka shkelur:

Policia e Kosovës, ka shkelur këto Dispozita Ligjore të LPP-së, si ne vijim:

Neni 1 te LPP-se

Neni 2 te LPP-se

Neni 6 te LPP-se

Neni 7 te LPP-se

Neni 24 par. 2 dhe 3 te LPP-se

Neni 51 te LPP-se

Neni 52 te LPP-se

Neni 56 par. 3 te LPP-se

Neni 59 par. 2 dhe 4 te LPP-se

Neni 60 te LPP-se

Neni 72 te LPP-se

Neni 108/A par. 9 dhe 12 te LPP-se

Neni 39.8 te RRUOPP-se

Neni 41 te RRUOPP-se

Neni 47.19 te RRUOPP-se

AK – POLICIA E KOSOVËS , me date 28.04.2023, përmes platformës elektronike eprokurim ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK (B58), duke shkelur dispozitat ligjor të LPP-së, ku do te shtjellojmë si ne vijim te kësaj deklarate me fakte dhe argumente! Pretendimet ankimore nga GOE: S.V. "Veterina" & NNP "WENDA" si pale me interes sipas nenin 4 par. 1.26 te LPP-se, lidhur me argumentet dhe faktet e shkeljeve

te dispozitave ligjore te LPP-së nga AK, si ne vijim:

Duke u bazuar tek kriteret e përzgjedhjes ne dosje te tenderit, - Kërkesat mbi

mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 2.2 te FDT-se janë:

Kërkesa 1. Stafi profesional për shërbimet e DDD:

3 Punëtorë teknik

Dëshmia 1. Listën e stafit profesional për shërbime të DDD nënshkruar dhe vulosur nga OE.

Minimum Tre (3) punëtorë teknik me eksperiencë në lëminë e DDD-së. Me Dy (2) vite përvojë pune të dëshmuar me referencë . Me Kontratë pune ose para kontrata e

punës valide me punëdhënësin për angazhim për këtë projekt.

AK Komisioni i vlerësimit, ZPP na kane eleminuar ne kete aktivitet te prokurimit me

arsyetimin ne letrën standarde te eliminimit me date 28.04.2023 si ne vijim:

Tenderi juaj esht ei papergjegjshem sepse nuk keni dorezuar:

Nga AK eshte kerkuar Lista e stafit profesional per sherbime te DDD nenshkruar dhe vulosur nga OE. Minimum Tre (3) punetore teknik me eksperience ne lemin e DDD-se. Me dy (2) vite pervoje pune te deshmuar me reference. Me kontrate pune ose para kontrate e punes valide me punedhenesin per angazhimin per kete projekt.

-Ne kete rast OE referencat te cilat ua ka leshuar punetoreve te vet i ka te pa nenshkruara dhe te pa vulosura.

Ne listen e satafit nuk eshte emri i nje puneotri F. rrahmani por vetm kontrata e lidhur ne mes tij dhe punedhenesit dhe punetoreve te cilet jane ne liste nuk jane ne rregull(nenete tyre bien ndesh me njera tjetren). Kontrata e V. Sadiku tek Neni 2 ceket s ekjo kontrate nuk mund te jete m ee gjate se 120 dite kalendarikebrenda nje viti kalendarik, kurse tek neni 6 ceket se punemarresi do te angazhohet nga dt. 01.01.2018 deri ne kohe t epacaktuar. E njejta kontrate vlen edhe per punemarresin tjeter A. Osmani ku ndryshon vetem data e angazhimit 01.04.2019. Tek kontrata tjeter B. Maloku Neni 2 thote se kjo kontrate nuk mund te jete me e gjate se 2 vite kurse tek neni 6 ceket se punemarresi do te angazhohet per 36 muaj per projektin

ne fjale. E njejta kontrate eshte edhe e punemarresit A. Vllahija. Kurse tek kontrata e punemarresit V. Hyseni perveq nenit 2 ku thote s ekjo kontrate nuk mund te jete me gjate se dy vite, kurse tek neni 6 thuhet se punemarresi do te angazhohet nga data 22.03.2021 deri 22.03.2022 me mundesi vazhdimi deri ne perfundimin e

projektit ne fjale (kurse projekti eshte publikuar 10.06.2022).

Duke marr për bazë kërkesën ne Dosjen e tenderit dhe arsyetimin e dhënë me rastin e

eliminimit nga AK -

Komisioni i vlerësimit, vërehet se AK ka shkelur dispozitat ligjore te LPP-se konkretisht nenin 56 par. 3 te LPP-se, si dhe nenin 59 par. 2 dhe 4 te LPP-se, sepse ne dosjen e tenderit është kërkuar te dëshmohet lista e stafit te OE e nënshkruar dhe e vulosur – te cilën liste ne kemi dorëzuar te nënshkruar dhe te vulosur, ndërsa është kërkuar qe OE te këtë minim tre (3) punëtorë teknik me eksperiencë në lëminë e DDD-së. Me Dy (2) vite përvojë pune të dëshmuar me referencë . Me Kontratë pune ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin për angazhim për këtë projekt. Prandaj ne kemi dorëzuar dy(2) mjek – staf profesional si dhe kemi prezantuar ne liste ty teknik veterinar dhe 3 (tre) punëtorë DDD si dhe një (1) punëtorë te certifikuar për DDD qe do te thotë ne total ne kemi ofruar shtate (7) punëtore lidhur me këtë aktivitet te prokurimit. Te cilët i kemi dorëzuar kontrata dhe referencat, mirëpo gjate ngarkimit te dokumenteve ne platformën elektronike e-prokurim ne kemi ngarkuar REFERENCAT e punëtorëve te cilat nuk janë te VULOSURA DHE TE NENSHKRUARA, por janë me data para hapjes se tenderit për këtë AP si dhe po ashtu ja rikujtojmë AK se ne dosjen e tenderit nuk është kërkuar qe referencat duhet te jene te nënshkruar, d.m.th. kështu është kërkuar ne dosje te tenderit: minim tre (3) punëtorë teknik me eksperiencë në lëminë e DDD-së. Me Dy (2) vite përvojë pune të dëshmuar me referencë, qe nuk e detyron OE te nënshkruaj referencat ne këtë rast sepse nuk ka qene kërkesë ne FDT, qe referenca duhet te jete e nënshkruar, prandaj vlerësimit duhet te bëhet ne harmoni te plote me kriteret e përzgjedhjes ne dosjen e tenderit si dokument themelor për përgatitjen e tenderëve nga OE.

Gjithashtu, ne konsiderojmë se kemi dorëzuar tenderin ne pajtim me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 2.2 te FDT-se, kërkesa 1 dhe dëshmia 1 te FDT-se, sepse edhe pse ne kemi dorëzuar referenca te pa nënshkruar dhe t epa vulosura nga kompani këta punëtorë te prezantuar ne liste nga ana jone V.S. "Veterina"

janë punëtorë qe punojnë ne kompaninë tone me tepër se 3 vite kjo vërtetohet edhe nga ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVES, - ATK, sepse ne paguajmë edhe kontribute për këta punëtorë dhe AK – Komisioni i vlerësimit ka qene i obliguar fillimisht te respektoj kriteret e përcaktuar vete ne dosje te tenderit ku ka kërkuar REFERENCA, por nuk ka shkruar se këto referenca duhet te jene te nënshkruar, po ashtu këta punëtorë te

prezantuar ne ketë AP dhe ne këtë liste janë punëtorë te V.S. "Veterina" dhe kane përvojë mbi dy vite edhe pse nuk janë referencat e nënshkruar kjo dëshmon përvojën e punëtorë dhe nëse AK – Komisioni i vlerësimit ka pas dyshim DETYRIMISHT, kane qene te obliguar te kërkojnë sqarime sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-se, pasi qe ne i posedojmë te gjitha këto dokumente dhe garantojmë AK se këta punëtorë te prezantuar ne listën tone janë te specializuar për këtë lloj apo natyre te punëve pasi qe ne posedojmë disa kontrata me disa institucione ne nivel vendi dhe për çdo dite kryejma këto shërbime ne republikën e Kosoves, prandaj ne se bashku me këtë kërkesë për rishqyrtim do te bashkëngjisim dëshmimit tona. Ndërsa lidhur me arsyetimet ne letrën standarde te eliminimit se kontrata e punëtorëve nenet e atyre kontratave te punëtoreve janë ne mospërputhje ne kundërshtim mes veti ato kontrata janë te nënshkruar mes palëve dhe mund te jen gabime teknik qe nuk paraqesin ndonjë problem sepse ato kontrata jene mese punëdhënësit dhe punëmarrësit dhe AK – Komisioni vlerësimit duhet te sigurohet se këtë punëtorë te prezantuar nga ana jone janë punëtorë te kompanisë tone dhe çështja e kontratave është çështje e brendshëm

mes punëdhënësit dhe punëmarrësit.

PROVE 1: - Referencat e nënshkruar para datës se hapjes sepse edhe datat ne referenca janë po ashtu para datës se hapjes dhe kjo logjikisht nënkuptohet edhe pse parësi po cekim se AK nuk ka kërkuar qe referencat duhet te jene te nënshkruara apo te vulosura!.....prandaj ne kemi plotësuar kriteret e përcaktuara nga vete AK ne DOSJEN E TENDERIT – FDT.

PROVA 2: - Lista e punëtoreve te nxjerra nga Deklarimi i ATK-se, ku vërtetohet se ne plotësojmë kërkesën e dosjes se tenderit sepse ne këta punëtor paguajmë edhe kontribute

ne ATK dhe janë punëtorë te kompanisë tone.

VEMENDJE: PER ESH DHE PSH

Ne konsiderojm dhe jemi te bindir se kemi arrit te plotesojme te gjitha kriteret e përzgjedhjes ne kete aktivitet te prokurimit per faktin se kemi dorezuar LISTEN E PUNETOREVE (te nenshkruar dhe te vulosur), kemi dorezuar 7 (Shtate) punetore te cilet ju kemi bashkangjitur certifikat te DDD qe vërtetohet se kan eksperience mbi 2 (dy) vite pervoje ne lemin e DDD, po ashtu kemi dorezuar REFERENCAT te leshuar nga Kompani S.V. Veterina (kompani lehon referonca per punetoret e vete edhe pse nuk jane te nenshkruar dhe te vulose aty kane firmen e kompanise S.V. Veterina dhe duke marr per baze se ne dosje te tenderit – FDT nuk ka qene kërkese se referencat duhet te jene te nneshkruar dhe te vulosura, pra logjikisht referenca nuk nenkupton se detyrimisht duhet te nënshkruhet dhe te vuloset , kur dihet se keta punetore jane puneore te deklaruar ne ATK nga kompani S.V. Veterina) Ndersa lidhur me gabimet apo mosperuthjen e kontratave qe AK arsyeton ne letren standarde te eliminimit dhe ne refuzimin e Kerkese per rishqyrtim, konsiderojm se AK ka kërkuar vetem kontrata pune pa specifikuar kushtet tjera, sepse kontrata mese punedhenesit dhe punemarresit eshte qeshtej e mbrendeshme e tyre si dhe AK nuk ka kërkuar ndonje specifik perveq se KONTRATE prandaj ne kemi arrit te

plotesojm kete kërkese dhe ato gabime jane teknike dhe nuk duhet te ndikojn aspak ne kete aktivitet te prokurimit sepse ne kemi deshuar dhe argumentuar edhe permes EDI deklarimit ATK se keta jane punetore te kompanise tone per te cilet paguajm edhe trustin dhe obligimet tjera, prandaj AK – ZPP na eliminon dhe diskriminon duke shkelur nenin 59.2 dhe 72 nese akoma dyshon , por pas deklarimit te ATK ska hapësire per dyshime te mëtejme, sepse ne kemi argumentuar me prova konkrete se ne plotesojm kete kërkese te

FDT-se dhe jemi kompani e specializuar ne kete lemi, prandaj AK ka shkelur qëllimin dhe

dispozitat ligjore te LPP-se me vete fakitin kur na ke elminuar padrejtësisht pasi qe sipas

nenit 60 te LPP-se n ejemi GOE qe plotesojm ne teresi kriteret e përzgjedhjes dhe duhet te

rekomandohemi per dhenie te kontrates ne kete aktivitet te prokurimit.

Duke u bazuar ne faktet e lartcekura, kuptohet qarte se ne në këtë aktivitet te prokurimit për jemi

eliminuar pa ndonjë baze ligjore dhe për shkak te lëshimeve qe AK-ja i ka bere, veprim ky i cili

nuk mund dhe nuk duhet te ndodh për shkak se ne jemi OE i përgjegjshëm dhe me çmimin me te

lire ne këtë aktivitet te prokurimit, andaj edhe është dashur te rekomandohemi për kontrate. Pasi

qe ne jemi ofertues me te lire, kurse ofertuesi i rekomanduar për dhënie te kontratës është me

çmim me te larte se ne.

Nga veprimet e AK-se neve po na krijohet përshtypja qe e njëjta pasi qe e ka pare se nuk mund te

na eliminoj me arsyetimin qe e ka dhanë ne letrën standarde për tenderues te eliminuar, tani po

nxjerr një arsyetim absurd duke ju referuar se referencat janë te pa nënshkruar te cilat e kemi

prezantuar ne këtë aktivitet te prokurimit, dhe për te cilat nuk është kërkuar te jen te nënshkruar

dhe te vulosura pasi qe këta punëtorë janë punëtorë qe punojnë ne kompaninë tone dhe referencat

pranohen edhe te pa nënshkruar dhe nuk paraqet ndonjë devijim nga kërkesat e dosjes se tenderit.

Autoriteti kontraktues ka mundur te kërkoj sqarime ne lidhje me dëshmitë e prezantuara nga ana

jone, konforme dispozitave te nenit 59.2 dhe 72 te LPP-se dhe ne do të i kishim ofruar dëshmitë e

kërkuara. Sa për korrektësi, bashkangjitur keni edhe një herë listën e punëtoreve me ATK

dhe referencave - Sikurse PROVA 1 dhe PROVA 2

Duke u bazuar ne dëshmitë dhe faktet qe u ceken me lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe

krahasimi i tenderëve nuk është bërë ne harmoni me nenin 59 dhe 60 te LPP-së dhe njëkohësisht

nuk është respektuar edh kriteri kryesore për dhënie te kontratës, e qe ka qene tenderi i

përgjegjshëm me çmimin me te ulet, sipas nenit 60 paragrafi1.1 i LPP-së.

Me fjale tjerat me këtë vlerësim, ekzaminim dhe krahasim te tenderëve nga AK ne kundërshtim me dispozitat ligjore te LPP-se, konkretisht ne kundërshtim me nenin 1, 2, 6 dhe 7 të LPP-së na eliminon nga ky aktivitet i prokurimit duke na diskriminuar dhe duke favorizuar një OE i cili është me çmim me te lartë se sa ne duke dëmtuar buxhetin e Kosoves, duke shkelur qellmini e prokurimit dhe ekonomicitetin dhe efakiasitetin si qëllime kryesore te Prokurimit Publik ne RKS, duke na eliminuar padrejtësisht për disa gabime minore te cilat bazuar ne dispozitën ligjore te LPP-se, konkretisht nenin 59 par. 2

dhe par. 4 te LPP-se shumë lehët ka mundur te sqaroj dhe te sigurohet se te gjitha ato arsyetime ne letrën standarde te eliminimit janë vetëm devijime, gabime apo paqartësi te cilat sipas nenit 59. 4 te LPP-se i cili kërkon qe gabimet dhe mangësitë duhet te korrigjohen dhe qe devijimet e vogla duhet te kuantifikohen si devijime te vogla me qellim te neutralizimit te efektit ne krahasimin e tenderëve, pasi qe këto mangësi nuk janë apo/ose nuk prekin aspektin material sepse nuk ndryshojnë kushtet e kontratës ne lidhje me cilësinë dhe qëllimin baze apo/ose kapacitet funksionale te kontratës dhe autoriteti kontraktues obligohet apo/ose do te jete ne gjendje te pranoj devijime te vogla pasi qe këto gabime shume lehte mund te vërtetohen dhe argumentohen se GOE me rastin e tenderimit i ka pasur, ka plotësuar te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit duke sjelle listën e stafit te nënshkruar dhe te vulosur si ne pajtim te plote me dosjen e tenderit dhe me kryesorja ka plotësuar te gjitha kërkesat e Dosjes se tenderit duke plotësuar te gjitha kriteret e

përzgjedhjes si dhe kriterin kryesorë çmimin me te ulëte te përgjegjshëm ne këtë aktivitet

te prokurimit.

AK te ruhej parimi kryesor i prokurimit "Vlera për Paranë" dhe te hap konkurrencën

dhe te rrit transparencën dhe barabarësinë duke na mundësuar te tenderojmë! Nëse nuk

merren për baze sqarimi ynë ne do te detyrohemi pa vullnetin tone te ju drejtohemi AK

dhe OSHP te mbrojmë mundësin për tenderim!

AK është i obliguar te ruhej/respektoj parimi kryesor i prokurimit me integritetin dhe

përgjegjësinë dhe te dhe te rrit transparencën dhe barabarësinë duke ndjekur parimin e

shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve

publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

Nëse nuk merren për baze sqarimi ynë ne do te detyrohemi pa vullnetin tone te ju

drejtohemi fillimisht ju si AK dhe pastaj OSHP-se, te mbrojmë integritetin dhe te

shpallemi fitues ne këtë aktivitet te prokurimi si tenderues i përgjegjshëm me çmimin me

te ulëte! përgjegjshëm!

Duke u bazuar ne dëshmitë dhe faktet që u ceken me lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe

krahasimi i tenderëve nuk është bërë ne harmoni me nenin 1, 2, 6, 7, 24, 51, 52, 56, 59, 60 dhe 72

të LPP-së.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 te LPP-se, ku edhe pse i kemi plotësuar te

gjitha kërkesat e FDT-se dhe te njoftimit për kontrate nuk jemi rekomanduar për kontrate.

Paragrafi 1 i nenit 7 te LPP-se e parasheh qarte qe "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatoret

ekonomik ne mënyrë te barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do te veproje ne mënyrë transparente.

Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 te LPP-se e parasheh qe Gjate udhëheqjes se aktiviteteve te prokurimit, te gjitha autoritetet kontraktuese do të siguroj: që (vi) qe tenderi i zgjedhur te përputhet me te gjitha aspektet përmbajtsore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse",

mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Ne këtë raste, AK-ja ka vepruar ne kundërshtim me këtë dispozite sepse tenderi/OE i rekomanduar

për kontrate nuk është ne përputhje te plote me te kriterin kryesor te shpërblimit me kontratë, prandaj është dashur te rekomandohemi si GOE për dhënie te kontratë ne këtë aktivitet te prokurimit.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur ne konsideratë edhe nenin 1 te LPP-se, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroje mënyrën me efikase, me transparente dhe me te drejte te shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera

te autoriteteve kontraktuese ne Kosovë.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kriteret e Dhënies	30.1	Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më te ulët** apo

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

LISTA E PLOTË STANDARDE E RADHITJES SË TENDERËVE SIPAS KRITERIT TË DHËNIES
Tenderi i pergjegjshem me cmimin me te lire

Sipas Nenit 60.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Kjo listë duhet të largohet nga raporti, në qoftë se kriteri për dhënien e kontratës është përcaktuar "Tenderi përgjegjës ekonomikisht më i favorshëm".

Radhë	Lënda / grupi: Shërbime të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në objektet Policore.	Çmimi total i ofertës (me TVSH)
1.	DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K., 811498957	192,669.56
2.	FLOMED SH.P.K., 811342930	232,551.08

IDENTIFIKIMI I TENDERUESVE TË REKOMANDUAR PËR DHËNIE TË KONTRATËS

Nr:	Grupi:		
1	Shërbime të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në objektet Policore.		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi poštar**	**Adresa**
	DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K., 811498957	-	Taslixhe II

DEKLARATË

Komisioni i Vlerësimit të Tenderit, pas vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve konstaton se për këtë aktivitet janë pranuar shtatë (7) oferta, të cilat pas vlerësimit kanë rezultuar se vetëm dy prej ofertave të pranuara janë të përgjegjshme dhe i plotësojnë të gjitha kriteret e kërkuara nga AK. Komisioni i vlerësimit rekomandon që OE DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K me çmimin më të ulët të shpërblehet me kontratë.

B36 Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve– procedura e hapur

12

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

Pretendimet ankimore nga GOE: S.V. Veterina & NNP WENDA janë pale me interes sipas nenin 4 par. 1.26 te LPP-se, lidhur me argumentet dhe faktet e shkeljeve te dispozitave ligjore te LPP-së nga AK,

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **S.V.„Veterina**

Përgjigjje në pretendimin ankimor

Pretendimi ankimor i OE ankues ka të bëjë me listen e stafit e që pretendon që e ka plotësuar sipas kritereve të dosjes së tenderit.

Në dosje të tenderit është kërkuar:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2

Kapaciteti teknik dhe professional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
Kërkesa 1. Stafi profesional për shërbimet e DDD: **3 Punëtorë teknik**	**Dëshmia 1. Listën e stafit profesional për shërbime të DDD nënshkruar dhe vulosur nga OE.** **Minimum Tre (3) punëtorë teknik me eksperiencë në lëminë e DDD-së. Me Dy (2) vite përvojë pune të dëshmuar me referencë . Me Kontratë pune ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin për angazhim për këtë projekt.**

OE ankues ka ofertuar dhe prezantuar në dosjen e tij listen e stafit duke i prezantuar 9 puntor/e me përvoj pune më shumë se që është kërkuar në dosje të tenderit.

Lista e stafit te puntorve

	Emri e Mbiemri	Mosha	Profesioni shkollimi	Eksperienca	Pozicioni ne Kompani
1.	Safet Osmani	28.03.1973	Teknologji ushqimore Mjek Veteriner I qertifikuar per DDD	25-VJET	Menaxher I Kompanis
2.	Valbone Sadiku	03.02.1982	Menaxhim I Emergjencave Bujqesi Veterinari E qertifikuar DDD	4-Vjet	Menaxhere e Projekteve
3.	Fitim Xhema	11.08.1990	Teknik Veteriner	6-vjet	Teknik Veteriner
4.	Anisa Osmani	26.08.2002	Ekonomiste e diplomuar E qertifikuar DDD	3- vjet	Puntore DDD
5.	Zenun Haxhinikaj	22.10.1981	Teknik Veteriner	3-vjet	Teknik Veteriner
6.	Mithat Eminovic	20.02.1965	Specialist I Epidemiologjis	3-vjet	Epidemiolog
7.	Valon Hyseni	16.10.1998	Puntor DDD	4-vjet	Puntore DDD
8.	Bislim Maloku	28.12.1982	Puntor DDD	4-vjet	Puntore DDD
9.	Arben Vllahija	07.04.1974	Puntor DDD	4-vjet	Puntore DDD
10					

S.V.VETERINA

.....

DERATIZIM-DEZINSEKTIM-DEZINFEKTIM S.V. VETERINA VUSHTRRI

Autoriteti Kontraktues më 27.04.2023 ka publikuar Njoftimim Mbi Vendimin e AK-së duke e eleminuar OE ankues me këto pretendime:

Letër standarde për tenderuesin e eliminuar [5]

24/04/2023, Prishtinë

POLICIA E KOSOVES, Rr "Luan Haradinaj"- nr. 99 ndërtesa e re e Administratës te Policisë, kati II, zyra e Prokurimit nr. 31, Prishtinë, Kosovë

Operatori Ekonomik: Grup i Operatorëve Ekonomik S.V.Veterina; & N.N.P. Wenda , VUSHTRRI

Nr. i prokurimit:	**214-22-5200-2-1-1**
Nr i brendshëm	**214/22/078/211**

Titulli: **Shërbime të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në objektet Policore.**

I/e nderuar(a) - Grup i Operatorëve Ekonomik S.V.Veterina; & N.N.P. Wenda , VUSHTRRI

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".
Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Tenderi i juaj është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar:

Nga AK është kërkuar Lista e stafit profesional për shërbime të DDD nënshkruar dhe vulosur nga OE. Minimum Tre (3) punëtorë teknik me eksperiencë në lëminë e DDD-së. Me Dy (2) vite përvojë pune të dëshmuar me referencë . Me Kontratë pune ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin për angazhim për këtë projekt.

- Në këtë rast OE referencat të cilat ua ka lëshuar punëtorve të vet i ka të pa nënshkruara dhe të pa vulosura.

Në listën e stafit nuk është emri i një punëtori F. Rrahmani por vetëm kontrata e lidhur në mes tij dhe punëdhënsit, kurse përvoja nuk është e prezentuar me referencë. Gjithashtu kontratat e lidhura në mes punëdhënsit dhe punëtorve të cilët janë në listë nuk janë në rregull (nenet e tyre bien ndesh me njëra tjetrën). Kontrtata e V. Sadiku tek Neni 2 ceket se kjo kontratë nuk mund të jetë më e gjatë se 120 ditë kalendarike brenda një viti kalendarik, kurse tek Neni 6 ceket se punëmarrsi do të angazhohet nga dt. 01.01.2018 deri në kohë të pa caktuar. E njejta kontratë vlenë edhe për punëmarrsin tjetër A. Osmani ku ndryshon vetëm data e angazhimit 01.04.2019. Tek kontrata tjetër B. Maloku Neni 2 thotë se kjo kontratë nuk mund të jetë më e gjatë se 2 vite kurse tek Neni 6 ceket se punëmarrsi do të angazhohet për 36 muaj për projektin në fjalë. E njejta kontratë është edhe e punemarrsit A. Vllahija. Kurse tek kontrata e punëmarrsit V. Hyseni përveq Neni 2 ku thotë se kjo kontratë nuk mund të jetë më e gjatë se dy vite, kurse tek Neni 6 thuhet se punëmarrsi do të angazhohet nga 22.03.2021 deri 22.03.2022 me mundësi vazhdimi deri në perfundim të projektit në fjalë (kurse projekti është publikuar 10.06.2022).
Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.
Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt

Është evidente se AK-ja ka gjetur mangësit e OE ankues pasi që kontratat e puntorëve kanë mangësi dhe mospërputhje të neneve të tyre dhe referencat e puntorëve nuk i ka të vulosura dhe nënshkruara.

Megjithatë eksperti shqyrtues vlerson që Autoriteti Kontraktues konform nenit 72 të LPP-së ka qenë e Obliguar që ti kërkoj informata shtesë OE.

Neni 72

Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomik është ose duket të jetë jo i plotë ose I gabuar, ose kur mungojn dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojn nga operatoret ekonomik që të dorëzoojn, plotësojn, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2. Autoriteti Kontraktues mund të ftoj operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësoj1% certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

3. Sigurimi I informacionit që mungon ose ofrimi I informacionit do të aplikohet vetëm p1%r dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar,para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive

Në këtë rast eksperti shqyrtues vlerson konform nenit 72 paragrafi 1 i LPP-së se dokumentacioni i OE ankues është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar dhe në rastin konkret AK-ja është dashtë që të kërkoj nga OE informacione shtesë që të dorzojn, plotësojn, sqarojn apo kompletojn informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor.

Eksperti shqyrtues vlerson që konform nenit 72 të LPP-së paragrafi 2 i cili përfshinë nenet nga 65 deri 71 dhe në këtë rast kemi të bëjmë me kapacitetin tekinik ose profesional i cili përfshihet në nenin 69 të LPP-së Aftësia Teknike ose Profesinale është dasht të kërkoj informacine shtesë

Neni 69

Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

4. Në proceduarat që shpien në dhënjen e kontratës publike në të cilën përfshihet sigurimi I shërbimeve, autoriteti kontraktues mund të kërkoj nga operatorët ekonomik të sgurojnë të dhënat me të cilat dëshmohet aftësia e tyre për sigurimin e këtyre shërbimeve: në veçanti të dhënat mund të kërkohen lidhur me shkadhtësit, efikasitetin, kapacitetin, përvojen dhe besueshërinë. Të dhënat përkitazi me aftësitë teknike të operatorëve ekonomik mund të parashtrohen përmes një ose më shumë mjeteve në vijim, sipas llojit,sasisë dhe qëllimit të shërbimeve që duhet të furnizohen:

4.1 kualifikimet shkollore dhe profesionale të përsonelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe në veçanti, të përsonit ose përsonave që drejtëpërdrejtë është ose janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve.

4.3 një shënim të përsonelit teknik ose organeve teknike të përfshira, pavarsisht se a I takojn1% ose nuk I takojnë drejtëpërdrejt operatorit ekonomik, sidomos për ata që janë përgjegjës p1%r kontrollimin e cilësisë.

4.4 raportin mbi fuqinë mesatare punëtore dhe numrin mesatar të përsonelit udhëheqës të operatorit ekonomik për secilin nga tri vitet e fundit.

Eksperti shqyrtues vlerson që konform nenit 72 të LPP-së paragrafi 1,2,3 nenit 69 paragrafit 4

nënparagrafit 4.1, 4.3 dhe 4.4 Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar që të kërkoj informata shtesë ndaj OE ankues.

Oe ankues edhe në Kërkesen Për Rishqyrtim të cilën e ka bërë në Autoritetin Kontraktues **03.05.2023** ka ofruar listen e puntorëve nga ATK-ja ,kontratat e puntorëve dhe referencat e tyre konform dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Eksperti Shqyrtues vlerson që këto kanë qenë dëshmi të mjaftueshme që AK ka mundur ta kthej lënden në rivlersim duke pasur parasysh që OE ka qenë OE më i lirë dhe duke u bazuar në nenin 72 të LPP-së.

Në mënyrë që të respektohen nenet e LPP-së të pretenduara nga OE se janë shkelur dhe në mënyrë që të ketë barazim në trajtimin e OE eksperti shqyrtues vlerëson që lënda duhet të kthehet në Rivlersim.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **S.V.„Veterina**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Rrahim Ademi